



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Predato Received / Delivered	07.12.2021	viti god year	
Organ / Rjesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shkronja Ulog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP-BJHCV	5849/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.859/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdy Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.859/2021 të datës 11.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr.“Nuhi Gashi”, Podujevë, kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.859/2021 të datës 11.10.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës, me datë 11.10.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër 04/2021 të datës 20.09.2021 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen brenda Kategorisë në Shërbimin Civil, pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me pretendimin ankimor që i njëjti është në kundërshtim me Rregulloren Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 14.10.2021 ka përcjellë kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datë 25.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.



Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-se, me Vendimin nr.55/2021 të datës 22.11.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.859/2021 të datës 11.10.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova:
Ankesën me numër protokolli 4986/2021 e datës 11.10.21 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga për Ankesa KPMSHCK i datës 11.10.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 14.10.2021; Diplomë me nr. 5059 i datës 26.03.2015; Konkurs për Lëvizje brenda kategorisë i datës 21.07.2021; Vendim me nr. 02/112 i datës 20.09.2021; Ankesë drejtuar Komisionit për vlerësimin e lëvizjes brenda kategorisë (KVLBK) i datës 13.09.2021; Përgjigje në ankesë e datës 25.10.2021; Njoftim për listën e ngushtë i datës 19.08.2021; Lista e Aplikantëve; Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 07.09.2021; Vendim me nr. 02/02 i datës 18.08.2021; Diplomë me nr. 2445 i datës 02.03.2011; Diplomë me nr. 233 i datës 07.07.1992; Certifikatë nr. i certifikatës 286/2020; Vendim me nr. 1171 i datës 15.07.2020; Vendim me nr. 02/96 i datës 02.04.2019; Akt Emërimi i datës 05.09.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 20.01.2015; Fletëreferencë e datës 25.05.2006; Vërtetim i datës 16.12.2019; Letër Rekomandim nga BZMF/Ëorlrd Relief për A.D.; Kurs i Teknologjisë së Informacionit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 14.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.12.2019; Vërtetim i datës 09.08.2021; Certifikatë nga Financial Laë Smart Agency për A.D.; Certifikatë e datës 25.03.2015; Certifikatë e datës 08.12.2016; Certifikatë e datës 06.12.2019; Certifikatë e muajit Qershor 2018; Certifikatë e datës 19.01.2021; Certifikatë e muajit shkurt 2016 deri nëntor 2017; Certifikatë e datës 03.04.2008; Certifikatë e datës 07.06.2006; Certifikatë nga OSCE e vitit 2005; Certifikatë e datës 10.12.2004; Diplomë me nr.866 e datës 20.04.2001; Certifikatë e datës 01.08.2017; Vërtetim për periudhën e punës i datës 10.08.2021; Dëshmi për masë disiplinore i datës 10.08.2021; Vërtetim i datës 25. 10.2011; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 20.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2019 i datës 23.12.2019; Diplomë me nr. 799 i datës 25.02.2004; Diplomë me nr. 001/12 i datës 25.01.2012; Certifikatë e datës 15.11.2010; Certifikatë e datës 20.09.2011; Certifikatë e datës 10.12.2012; Certifikatë e datës 04.11.2013; Certifikatë e datës 02.06.2014; Certifikatë e datës 09.06.2014; Certifikatë e datës 20.10.2014; Certifikatë e datës 23.11.2015; Kontratë Pune e datës 12.05.2008; Akt Emërimi i datës 02.02.2012; Kontratë Pune e datës 04.03.2011; Kontratë Pune e datës 03.03.2011; Kontratë Pune e datës 03.06.2010; Vendim me nr.05/2021 i datës 28.01.2021; Vendim me nr.05-1/2021 i datës 29.06.2021; Vërtetim i datës 29.07.2021; Letër Referencë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave për D.K.; Diplomë e datës 01.06.2003; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 31.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 10.12.2019; Dëshmi për masë disiplinore i datës 29.07.2021; Vërtetim i datës 07.07.2021; Dëshmi për masë disiplinore i datës 29.07.2021; Vërtetim i datës 07.07.2021; Diplomë me nr. 486 i datës 20.03.2003; Certifikatë e datës 05.06.2019; Certifikatë e A.P. e vitit 2004; Certifikatë e datës 19.05.2020; Vendim me nr.32/2016 i datës 29.07.2016; Dëshmi për masë disiplinore e datës 29.07.2021; Vërtetim për periudhën e punës i datës 09.08.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 22.01.2021; Formulari për vlerësimin e

rezultateve në punë 2019 i datës 26.12.2019; Diplomë me nr. 5059 i datës 26.03.2015; Diplomë me nr. 2041 i datës 01.11.2019; Certifikatë Auditorë e Brendshëm i Certifikuar i datës 06.04.2021; Certifikatë nga ShKÇAK për V.P. e vitit 2015; Certifikatë e datës 15.10.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.11.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.02.2020; Vërtetim me nr. 13-113/02-0060630/21 i datës 27.07.2021; Vërtetim nga kompania N.Sh. Accountant i vitit 2020; Vërtetim me nr. 13-116/01-0060638/21 i datës 27.07.2021; Diplomë me nr. 898 i datës 08.11.2004; Certifikatë e datës 10.01.2020; Certifikatë e datës 02.05.2018; Dëshmi për masë disiplinore i datës 17.05.2021; Vërtetim për periudhën e punës i datës 17.05.2021; Akt Emërimi i datës 07.12.2011; Vendim me nr.23/2020 i datës 21.04.2020; Vendim me nr.53/2020 i datës 10.07.2020; Referencë e datës 01.04.2016; Letër Referencë e datës 28.08.2015; Vendim i datës 18.12.2014; Vendim me nr.04/2014 i datës 29.09.2014; Vërtetim i datës 10.05.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional; Certifikatë e datës 07.05.2012; Certifikatë e datës 06.04.2018; Certifikatë e datës 15.12.2016; Certifikatë e datës 03.11.2016; Certifikatë e datës 28.07.2000; Certifikatë e datës 20.04.2015; Certifikatë e datës 13.06.2013; Certifikatë e datës 12.03.2012; Referencë e datës 05.02.2010; Certifikatë e datës 05.08.2004; Certifikatë e datës 14.01.2002; Certifikatë e datës 27.05.2002; Certifikatë nga Ifes për B.B; Pliko me nr. 1437-2/2021 i datës 25.10.2021; E-mail i datës 16.11.2021; Konkurs i datës 21.04.2021; Akt Emërimi i datës 01.08.2020; Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës i datës 13.08.2021; Njoftim për kandidatët fitues i datës 08.09.2021; E-mail nga për F.G i datës 29.10.2021; E-mail nga për i datës 27.10.2021; E-mail nga për i datës 25.10.2021; E-mail nga për i datës 25.10.2021; E-mail nga për i datës 25.10.2021; E-mail nga A.D. për O.D. i datës 14.09.2021; Lista e Aplikantëve;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vendosur të bëjë përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit

sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me datë 21.07.2021 ka shpallur konkursin me nr.ref.RP00007311 për "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës Auditor i Brendshëm", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Komisioni për Vlerësim i themeluar sipas Vendimit Nr.161/2021 të datës 18.08.2021, pas përfundimit të procedurës së intervistimit, me datë 07.09.2021 ka përgatitur listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas të cilës ankuesi është listuar si kandidati i katër me gjithsejtë 71.2 pikë. Bazuar në listën përfundimtare të Komisionit Vlerësues, Divizioni për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 08.09.2021 ka publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, përmes të cilit, kandidati është rekomanduar për emërim në pozitën e punës "Auditor i Brendshëm".

Me datë 07.09.2021 Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil (KVLBK) ka hartuar listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve ku ankuesi nuk ka qenë si kandidati më e vlerësuar respektivisht kandidat fituese.

I pakënaqur me listën përfundimtare të datës 08.09.2021, ankuesi me datë 13.09.2021 ka parashtruar ankesë pranë Komisionin të Vlerësimit, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër 04/2021 të datës 20.09.2021, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, me arsyetimin se pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me fazën e vlerësimit.

Kundër Vendimit me numër 04/2021 të datës 20.09.2021 të Komisionit të Vlerësimit, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se që i njëjti është në kundërshtim me Rregulloren Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se kandidatja si aplikuese në Konkursin me nr.ref.RP00007311 për "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës Auditor i Brendshëm", me datë 22.10.2021 ka pashtuar ankesë në KPSHCK me numër A.nr.883/2021 të datës 22.10.2021, duke kundërshtuar përzgjedhjen e kandidatit fitues për këtë pozitë. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e vendosjes së ankesës së me Vendimin A.nr.883/2021 të datës 02.12.2021 ka anuluar procedurën e "Lëvizje brenda kategorisë" me Nr.ref.RP00007311 për pozitën Auditor i Brendshëm" i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me këtë procedurë të rekrutimit. Andaj, bazuar në këtë konstatim si dhe në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", Kolegji ka vendosur që të përfundoj procedimi administrativ i incizuar me ankesën me numër A.nr.859/2021 të datës 11.10.2021, pasi që objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.859/2021

Avdyl Bekteshi

Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Dëmi

Ardita Haxhnikaj-Dëmi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë Punës dhe Transfereve; dhe Arkivit të KPSHCK- së

